



EUROPEAN
COMMUNITY
FOUNDATION
INITIATIVE

ANGAZHIMI I FONDACIONEVE
KOMUNITARE ME OZHQ-TË



LOCAL ACTION
FOR GLOBAL
GOOD



TË DHËNA MBI BOTIMIN

Informacione bibliografike mbi Bibliotekën Kombëtare të Gjermanisë (DNB):

Ky botim bën pjesë në Bibliografinë Kombëtare Gjermane të Bibliotekës Kombëtare të Gjermanisë. Të dhënat bibliografike të hollësishme janë të disponueshme në Internet, në faqen <http://dnb.d-nb.de>.

Botuesi:

Bundesverband Deutscher Stiftungen e.V. (Shoqata e Fondacioneve Gjermane)
Mauerstrasse 93 | 10117 Berlin | Gjermani
Telefon +49 (0)30 897 947-0 | Faks -11
www.stiftungen.org/verlag
post@stiftungen.org
© Bundesverband Deutscher Stiftungen e.V., Berlin 2020

Autorët:

Anja Böllhoff, Andrea Dicks, Dr. Annette Kleinbrod, Dr. James Magowan, Kaja Petryka

Menaxhimi i projektit:

Anja Böllhoff, Nisma Evropiane për Fondacionet Komunitare

Redaktorë:

Anja Böllhoff, Dr. James Magowan

Paraqitja grafike:

Nina Reeber-Laqua, reeber design, Kronberg

Përktheu në gjuhën shqipe:

Language Solutions Albania, për llogari të Trag Foundation,
I Mileševska 5 | 11000 Beograd, Serbi,
+381 11 7839 467 e-mail; office@tragfondacija.org

Korrektori në gjuhën shqipe:

Partners Albania, Rr. e Elbasanit, Nd. Park Gate, Kati 10, Ap. 71 / 73, PO BOX 2418/1,
1010 Tiranë, Shqipëri; 04225488; partners@partnersalbania.org

Fotografi dhe ilustrime:

Fondacioni North Milan Greater Area, Fondacioni Komunitar i Northemptëshajërit,
Robert Haas, Peter Himsel, Yavor Lalev, Shoqata e Fondacioneve Gjermane a.o.

ISBN 978-3-948796-04-4

PASQYRA E LËNDËS

HYRJJE

Nga Dr. James Magowan dhe Anja Böllhoff 4

KONTEKSTI

Nga Dr. Annette Kleinbrod..... 6

ZBULIMI I POTENCIALIT TË VEPRIMEVE NË NIVEL VENDOR PËR TË MIRËN BOTËRORE

Nga Dr. James Magowan dhe Anja Böllhoff..... 8

FONDACIONËT KOMUNITARE NË VEPRIM - QASJA GJITHËPËRFSHIRESE

Nga Dr. James Magowan dhe Anja Böllhoff..... 10

OZHQ-TË PJESË INTEGRALE E FONDACIONEVE KOMUNITARE..... 12

INVESTIME TË LIDHURA ME MISIONIN PËR NJË NDIKIM MË TË MADH 13

TË DREJTOSH PËRMES STRATEGJIVE DHE VEPRIMEVE NË NIVEL VENDOR 14

PËRDORIMI I TERMINOLOGJISË SË OZHQ-ve..... 19

FILLONI NGA VETJA:ORGANIZATË E QËNDRUESHME 21

NGRITJA E NJË RRJETI KOMBËTAR PËR TË MËSUAR NGA NJËRI-TJETRI 22

SI MUND TA REALIZOJMË- 10 VEPRIME PËR TË PËRKRAHUR OZHQ-TË

Nga Dr. James Magowan dhe Anja Böllhoff 24

NDRYSHIMI VJEN NGA POSHTË-SI NDIKON AKADEMIJA NË NXITJEN E PUNËS NË TERREN

Nga Kaja Petryka 26

KANADA – PËRGATITJA E TERRENIT

Nga Andrea Dicks 31

URL-të..... 34

Rreth ECFI-së 37

» *"Tregohuni qytetarë të botës. Veproni me pasion dhe dhembshuri. Na ndihmoni që ta bëjmë botën më të sigurt dhe më të qëndrueshme për brezat e sotshëm dhe ata të ardhshëm. Kjo është përgjegjësia jonë morale."*

Ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban-Ki Moon, 2015



HYRJE



ECFI-ja ka marrë angazhimin që të ndërgjegjësojë fondacionet komunitare mbi aktualitetin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Ky angazhim na ka shoqëruar gjatë gjithë punës sonë, duke qenë pjesë e axhendës së veprimtarive të të nxënimit nga kolegët, prezantimeve dhe konferencave, si dhe kërkimeve dhe komunikimeve. Tashmë është e qartë se ndaj OZHQ-ve mbetet ende një ndjesi skepticizmi dhe madje rezistence, për shkak se mendohen të jenë larg punës së përditshme të fondacioneve komunitare ose se mundësia për të pasur ndikim në këto çështje të nivelit të lartë është e shumë e vogël. Qëllimi i këtij dokumenti është pikërisht të tregojmë se puna e të gjitha fondacioneve komunitare lidhet ngushtësisht me OZHQ-të, dhe se me zbatimin e "qasjes gjithëpërfshirëse", ku merret parasysh misioni, investimi, strategjitë dhe programet, komunikimet dhe operacionet, do të krijohet mundësia për ta shfrytëzuar kuadrin

në përmirësim të rolit, besueshmërisë dhe efektshmërisë, si katalizatorë të ndryshimit. Në këtë mënyrë mund të realizohet përfundimi i financimeve dhe partnerëve, motivimi i stafit, anëtarëve të bordit dhe vullnetarëve, si dhe konsolidimi i pozicionit që ka fondacioni në zonën ku ushtron veprimtarinë e tij.

Në këtë dokument paraqitet kontributi që mund të japin OZHQ-të për të ndërlidhur veprimet në nivel vendor me dobitë në nivel botëror. Krahas kësaj, dokumenti përfshin edhe format apo veprimet e ndryshme që janë ndërmarrë nga fondacionet komunitare për të përkrahur OZHQ-të. Ne shpresojmë që do të frymëzoheni të mësoni më shumë, të zhvilloni diskutimet e nevojshme, dhe të bashkërendoni punën e organizatës suaj me OZHQ-të, duke krijuar kështu një rreth virtuoze ku kuadri i OZHQ-ve ju ndihmon juve dhe fondacionin tuaj komunitar, çka rrjedhimisht kontribuon në arritjen e Objektivave.

Dr. James Magowan dhe Anja Böllhoff, Drejtore
Koordinues, Nisma Evropiane për Fondacionet
Komunitare

KONTEKSTI



FONDACIONET KOMUNITARE JANË DOMOSDOSHMERI E NGUTSHME PËR AXHENDËN E VITIT 2030!

Axhenda 2030, e cila përmban 17 objektiva dhe 169 qëllime të zhvillimit të qëndrueshëm, është një plan veprimi botëror që të gjithë të jetojnë në paqe e mirëqenie në të tashmen dhe në ardhmen. Synimi i axhendës është që progresi ekonomik në botë të jetë në harmoni me drejtësinë sociale dhe të respektojë kufijtë ekologjikë të planetit tonë. Axhenda shkon përtej diskutimeve të deritanishme në fushën e klimës dhe mjedisit, pasi ndjek një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërlihet me të gjitha OZHQ-të. Kjo nënkupton që duke neglizhuar një objektiv, ndikoni negativisht tek arritja e objektivave të tjera.

Zbatimi i OZHQ-ve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar deri në vitin 2030 është një qëllim shumë ambicioz. Thirrja për të vepruar vlen për të gjithë: qeveritë, bizneset, institucionet financiare, akademinë, shoqërinë civile dhe çdo individ. Objektivat do t'i arrijmë vetëm duke menduar jashtë kornizave, duke qenë të hapur ndaj formave

» *"Ky raport i ECFI-së është një koleksion i uyer shembujsh pozitivë të kontributit të fondacioneve komunitare në këtë axhendë."*

Dr. Annette Kleinbrod është Këshilltare e Agjencisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GIZ) GmbH, për llogari të Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe me mbështetjen e Shoqatës së Fondacioneve Gjermane

të reja të bashkëpunimit, dhe duke realizuar natyrën transformuese të axhendës.

Megjithatë, duhet të marrim parasysh se axhenda është një koncept botëror i zhvilluar i miratuar përmes një rezolute të OKB-së, çka nënkupton se ka një stil dhe qasje ndryshe nga mënyra se si angazhohen shumë aktorë të shoqërisë civile ndaj nivelit bazë.

Jo rrallëherë, gjatë punës sime më drejtohet pyetja nëse fondacionet, veçanërisht fondacionet komunitare vendore, mund të kontribuojnë në këtë koncept ndërkombëtar. Përgjigjja ime është: "Po, sigurisht që munden!" Fondacionet komunitare janë domosdoshmëri e ngutshme në zbatimin e OZHQ-ve. Krahasuar me format e tjera organizative, këto fondacione janë shumë më të efektshme në vendosjen e kontakteve midis qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit në zbatim të Axhendës, sidomos me aktorë nga fusha e politikës, biznesit,



"Sustain" (Përkthimi në gjuhën shqipe: Qëndrueshmëri), kongresi i parë i zhvilluar në shkurt 2019, në Mynih,


shkencës dhe akademisë. Si rrjedhojë e paanshmërisë së tyre, fondacionet komunitare janë instrumenti i duhur për të mundësuar takime dhe shkëmbime. Veç kësaj, duhet marrë parasysh se këto fondacione kanë mundësuar që qytetarët të bëheshin pjesë e

dhe të jepnin kontributin e tyre në diskutime dhe procese, pavarësisht dyerve të mbyllura në fazën fillestare. Një vlerë e shtuar e fondacioneve komunitare është fakti se e njohin mirë zonën që mbulojnë dhe janë fleksibël në gjetjen e zgjidhjeve të duhura, pavarësisht kompleksitetit të sfidave.

Ky raport i ECFI-së është një koleksion i vyer shembujsh pozitivë të kontributit që japin fondacionet komunitare ndaj axhendës. Kaq frymëzues! Ne jemi të motivuar që ta vijojmë bashkëpunimin me fondacionet komunitare dhe shumë palë të tjera interesi për një të ardhme më të mirë, ku askush nuk mbetet pas.



ZBULIMI I POTENCIALIT TË VEPRIMEVE NË NIVEL VENDOR PËR TË MIRËN BOTËRORE





FONDACIONET KOMUNITARE NË VEPRIM: QASJA GJITHËPËRFSHIRËSE

Duke ushtruar veprimtarinë e tyre në zona gjeografike të mirëpërcaktuara dhe duke pasur prani institucionale afatgjatë, fondacionet komunitare kuptojnë dhe adresojnë një sërë çështjesh komplekse dhe të ndërvarura në nivelin vendor. Falë kapacitetit për të krijuar dhe për të përdorur burime njerëzore, financiare, dhe fizike; njohurive mbi zonën që mbulojnë; dhe rolit që luajnë në fitimin e besimit dhe nxitjen e lidhjeve dhe marrëdhënieve midis njerëzve dhe institucioneve, fondacionet komunitare janë aktorë të rëndësishëm, madje në disa raste edhe drejtues, që mund të ndihmojnë në transformimin në nivel vendor. **Për këtë arsye, këto fondacione mundësojnë një lidhje të rëndësishme ndërmjet veprimeve në nivel vendor dhe aspiratave në nivel botëror.**

Duke qenë se OZHQ-të përfshijnë një gamë të gjerë fushash, është thuajse e pamundur që fondacionet komunitare mos të kontribuojnë në zbatimin e një ose disave prej tyre, përmes mbështetjes së veprimeve të ndërmarra nga baza dhe fuqizimit të komunitetit. Krahas kësaj, natyra universale dhe e ndërlidhur e Objektivave nënkupton se veprimet që kryhen lidhur me një Objektiv të caktuar mund të ndikojnë në disa objektiva të tjera. Për këtë arsye, ne duhet të kuptojmë tërësinë e axhendës së OZHQ-ve dhe të ndjekim një "qasje gjithëpërfshirëse".

Duke bashkërenduar veprimtarinë e tyre me dhe duke përkrahur OZHQ-të, fondacionet komunitare mund të vërtetojnë ndikimin dhe rolin e rëndësishëm të strategjive dhe punës së tyre, duke arritur kështu përfitim e financimeve dhe partnerëve, motivimin e stafit, anëtarëve të bordit dhe vullnetarëve, si

dhe konsolidimin e pozicionit të fondacioneve komunitare, si ndërlidhës të sektorëve publikë, privatë dhe jofitimprurës, në zonën ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Në këtë seksion, do të reflektojmë mbi praktika të ndryshme nga mbarë bota, në veçanti nga Evropa, ku fondacionet komunitare i kanë përdorur OZHQ-të për të përqendruar dhe për të përmirësuar ndikimin e tyre mbi popullsinë. Do të shqyrtojmë mënyrën se si këto fondacione i konceptojnë dhe i ndërlidhin OZHQ-të me misionin dhe punën e tyre, duke theksuar sfidat që duhet të kapërcejnë, mundësitë që lindin dhe ndryshimin që sjellin. Do t'iu referohemi shembujve ku fondacionet komunitare kanë:

- ristrukturuar misionin e tyre
- bashkërenduar strategjitë e investimit me OZHQ-të
- hartuar dhe zbatuar strategji dhe programe në përputhje me OZHQ-të
- përdorur terminologjinë e OZHQ-ve nëpër komunikime (veçanërisht në planifikim dhe raportim), si një mënyrë për të angazhuar qytetarët dhe palë të tjera interes, si dhe për të shfrytëzuar burimet)
- shqyrtuar veprimtaritë e tyre dhe ndikimin e OZHQ-ve

Një qasje gjithëpërfshirëse parashikon se çdo fazë, duke filluar nga misioni deri te veprimtaritë, duhet të shihet përmes lentes së OZHQ-ve.



Sipas kërkimeve tona, thuajse 60% e fondacioneve komunitare në Evropë tashmë e njohin lidhjen midis punës që bëjnë dhe OZHQ-ve. Në shumicën e rasteve, kjo lidhje realizohet duke bashkërenduar veprime të caktuara (programe ose grante) me një ose dy Objektiva. Në disa fondacione, kjo lidhje ka arritur deri në nivelin strategjik, ku kuadri i OZHQ-ve është baza e analizës së nevojave sipas fushave, si dhe e planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit. Një numër i vogël fondacionesh po punojnë drejt një qasjeje gjithëpërfshirëse, 360°. Ne besojmë se ky synim mund të arrihet nga të gjitha fondacionet komunitare, duke e shndërruar në tiparin e tyre kyç. E ku ka përgjigje më të mirë ndaj thirrjes universale për veprim?

» *“Fondacioni komunitar i Mynihut promovon zhvillimin e qëndrueshëm urban në qytet. Parimet kryesore janë drejtësia sociale, dhe përgjegjësia ekologjike dhe ekonomike në kontekstin botëror.”*

Ekstrakt nga misioni i Fondacionit Komunitar të Mynihut

Pjesëmarrja e Rrjetit për Varfërinë dhe Ushqimin në Northemптëshajër në javën e fushatës #EndHungerUK (#LeT'iJapimFundUrisëNëMbretërinë EBashkuar), nëntor 2019



OZHQ-të PJESË INTEGRALE E FONDACIONEVE KOMUNITARE



» *"Vizioni i Fondacionit është të krijojmë një kulturë kontribuimi që forcon dhe mbështet komunitetin vendor në një kontekst botëror, ndaj do të kryejmë një ulerësim të kontributit tonë, me qëllim që të pasqyrojmë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së."*

Rachel Mc Grath,
Fondacioni Komunitar i
Northemптëshajërit

Fondacionet komunitare udhëhiqen nga misioni i tyre, i cili përcakton qëllimin në raport me vlerat, kontekstin dhe vizionin që kanë. Ndonëse mund të mos jetë hapi i parë, konsiderimi i OZHQ-ve si pjesë integrale e fondacioneve komunitare garanton angazhim afatgjatë dhe gjithëpërfshirës. Tanimë, shumica e fondacioneve komunitare arrijnë ta bashkërendojnë misionin e tyre me objektivat e gjera të zhvillimit të qëndrueshëm. Për shembull, megjithëse janë themeluar përpara hartimit të OZHQ-ve, fondacionet e Frajburgut dhe Mynihut e kanë përfshirë qëndrueshmërinë dhe vlerën e veprimeve në nivel vendor në kontekstin botëror, në statutet dhe misionet e tyre.

Nisur nga kjo, të dyja këto fondacione komunitare i kanë bashkërenduar strategjitë e tyre të investimeve, politikat e financimeve, si dhe punën/veprimtaritë e përditshme me OZHQ-të.

Si një prej 46 fondacioneve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre thuajse në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar, Fondacioni Komunitar i Northemптëshajërit po kryeson lëvizjen në vend për ta analizuar aktualitetin e OZHQ-ve në mënyrë gjithëpërfshirëse, çka e vërteton përmes praktikave që ndjek. Duke qenë se është themeluar në vitin 2001, së fundmi bordi dhe stafi i fondacionit kanë rishikuar dhe kanë ndryshuar vlerat dhe vizionin e tyre për të njohur dhe për t'u angazhuar ndaj arritjes së OZHQ-ve.

Me anë të këtij vizioni, Fondacioni Komunitar i Northemптëshajërit shprehet si një aktor vendor, pjesë e një rrjeti ndërkombëtar më të gjerë, që ndjek praktika të mira dhe fuqizon ekosistemin e sektorit komunitar dhe atij vullnetar. Pas diskutimeve të komitetit të ndikimit dhe me kontributin e ekipit të stafit drejtues, në vitin 2019 fondacioni ra dakord t'i përfshinte OZHQ-të në Planin e Biznesit 2019 - 2020 dhe të angazhohej ndaj disa, ose të gjitha, Objektivave përmes punës së tij të përditshme.



INVESTIME TË LIDHURA ME MISIONIN PËR NJË NDIKIM MË TË MADH



FreiburgerBürgerstiftung

» *“Në investimin e asetëve, duhen marrë parasysh edhe aspektet ekologjike dhe etike.”*

Hanna Lehmann,
Fondacioni Komunitar i Northemptëshajërit

Lidhur me investimet, shtyllat kryesore të një strategjie investimesh janë aspektet ekonomike, si: kthimi financiar, siguria dhe likuiditeti. Fondacioni Komunitar i Frajburgut dhe fondacione të tjera kanë shtuar edhe një dimension të katërt, që është qëndrueshmëria.

Në udhëzimet për investimin e fondeve të kushtëzuara, fondacioni ka përcaktuar edhe nevojën për të investuar kryesisht në shoqëri dhe nisma të orientuara ndaj qëndrueshmërisë, që përmbushin kriteret etike, ekologjike dhe sociale. Në këtë mënyrë, fondacioni nuk mbështet sektorë, veprimtaria dhe produktet e të cilëve bien në kundërshtim me parimet dhe objektivat e tij. Këta sektorë përfshijnë:

industrinë e mbrojtjes, energjinë bërthamore, punën e detyruar të fëmijëve, etj. Krahas kësaj, vëmendje e veçantë i kushtohet punës me bankat vendore të kursimeve.

Fondacioni Komunitar i Irlandës së Veriut ka ndryshuar qasje, duke mos investuar më në fushat që përfshijnë duhanin, alkoolin, armatimet, lëndët djegëse fosile, etj., por duke u përqendruar tek investimet në politikat e punësimit, mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtat e njeriut. Së fundmi, ky fondacion ka krijuar një portofol me praktikë pozitive bazuar tek OZHQ-të dhe deri tani performanca nuk ka pësuar asnjë rënie.


TË DREJTOSH PËRMES STRATEGJIVE DHE VEPRIMEVE NË NIVEL VENDOR



Fondazione
di Comunità
di Messina

» *“Akhenda 2030 ofron një kuadër të fuqishëm për ta trajtuar kompleksitetin në nivel vendor: kapaciteti transformues i fondacionit në komunitetin ku ushtron veprimtarinë e tij dhe më gjerë lidhet me kapacitetin për të zbatuar njëkohësisht të gjitha OZHQ-të, si objektiva ndërdisiplinore dhe të ndërvarura, që zbatohen në mënyrë koherente.”*

Gaetano Giunta,
Fondacioni Komunitar i Messina

Kryesisht, fondacionet komunitare kanë formuar rrjete të shëndosha në zonat që mbulojnë, dhe arrijnë t'i shfrytëzojnë siç duhet njohuritë dhe ekspertizën e të gjitha palëve të përfshira në qytet/rajon. Si institucione afatgjata, neutrale, të pavarura dhe jofitimprurëse, ato janë të përshtatshme për të drejtuar nismat qytetare dhe për të vendosur kontakte të besueshme për administratën vendore. Sipas anketimit të ECFI-ve, fondacionet komunitare kanë ndërmarrë veprime në lidhje me të gjitha OZHQ-të, por veçanërisht me Objektivat 1, 2, 3, 4, 5, 10, 11,12,13, 16 dhe 17. Përvoja e nismës “Sfida Globale, Zgjidhje Vendore” (shihni faqen 26) tregon se Objektivat 1, 4, 11 dhe 17 kanë marrë vëmendjen kryesore. Shembuj të tjerë të bashkërendimit të projekteve dhe Objektivave specifike gjenden në raportet e GCLS-sënë këtë. 

Në nivelin vendor, ndërvarësia e Objektivave bëhet edhe më aktuale.

Për dekada të tëra, Fondacioni Komunitar i Messina-s ka qenë pararojë e risisë dhe shndërrimit ekonomik dhe social, duke mobilizuar veprime të drejtuara nga qytetarët, me qëllim shfrytëzimin e një morie hapësirash (duke përfshirë edhe hapësirat që më parë kanë qenë nën kontrollin e mafies) në dobi të publikut.

“Sustain” (Përkthimi: Qëndrueshmëri), kongresin e parë në Mynih, shkurt 2019





» *“Sipas mendimit tim, fondacionet komunitare, në veçanti, janë shumë të përshtatshme për promovimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në nivel vendor. OZHQ-të nuk mund të arrihen pa ndihmën e bazës. Dhe ndryshe nga fondacionet e tjera, ne si fondacione komunitare jemi në kontakt të ngushtë me qytetarët.”*

Carmen Paul,
Fondacioni Komunitar i Mynihut

Fondacioni Komunitar i Mynihut u themelua në vitin 2000 nga gjashtë qytetarë të Mynihut, me qëllim realizimin e proceseve të parashikuara në Axhendën vendore 2021.

Carmen Paul raporton mbi mënyrën se si, pas 20 vjetësh veprimtarie, ky fondacion komunitar tashmë po zgjeron ndjeshëm temën e qëndrueshmërisë.

Së bashku me organizata të tjera, Fondacioni Komunitar i Mynihut filloi Nismën e Qëndrueshmërisë së Mynihut. Në bashkëpunim me 50 organizata vendore, në shkurt 2019 u zhvillua kongresi i parë SUSTAIN, ku u trajtua mënyra se si qytetarët mund të kontribuojnë në zbatimin e OZHQ-ve në nivel vendor. Përveç palëve të interesit nga bota e biznesit, politikës,

administratës së qytetit, dhe shkencës, tetë grupe pune, të quajtura ndryshe “punëtori”, dhanë rekomandimet e tyre mbi tematikat që duheshin diskutuar me qytetarët në lidhje me OZHQ-të. Në kongres morën pjesë rreth 400 persona, duke vijuar me mbledhje tremujore, dhe një tjetër kongres që do të zhvillohet në vitin 2021.



SUSTAIN, kongresi i parë në Mynih, shkurt 2019





» "NMGAF-ja tregon angazhimin e saj ndaj përputhshmërisë së OZHQ-ve me të dhënat vendore, sugjerimet dhe evidencat e raportuara nga fokus grupet, si pjesë e veprimeve në nivel botëror për të përmirësuar cilësinë e jetesës së të gjitha komuniteteve në mbarë botën. Në këtë mënyrë, ne hodhëm hapat e parë drejt krijimit të një axhende të përbashkët në partneritet me agjenci dhe organizata publike, private dhe qeveritare, duke përfshirë drejtuesit e komunitetit në një diskutim të vazhdueshëm dhe në planin e veprimtarive të ardhshme të nismës "Vital Signs"."

Daniele Giudici,
Fondacioni North Milan Greater Area

Fondacione të tjera komunitare e përdorin kompetencën e tyre si qendër njohurish dhe rolin kyç si drejtues komuniteti për të bashkërenduar nismën „Vital Signs” (Shenja Jetike) me kuadrin e OZHQ-ve. Nisma "Vital Signs" është një metodologji të dhënash, përgatitur nga Fondacionet Komunitare të Kanadasë, që përdor të dhëna publike dhe njohuri vendore për të vlerësuar nivelin e jetesës së një komuniteti, dhe për të ndihmuar në gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për përmirësimin e cilësisë së jetës në zonën ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Kanadaja është nismëtarja e këtij rrugëtimi, duke filluar bashkërendimin e 191 fondacioneve komunitare sipas seteve të të dhënave kombëtare. Shembuj të tillë ekzistojnë në tetë vende evropiane (Bosnjë-Hercegovinë, Gjermani, Irlandë, Itali, Serbi, Sllovaki, Ukrainë dhe Mbretëri e Bashkuar), ku fondacionet komunitare e kanë ndjekur këtë qasje ose një tjetër

për të bashkërenduar planifikimin dhe analizën e nevojave sipas fushave me kuadrin e OZHQ-ve.

Duke bashkërenduar nismën „Vital Signs” me kuadrin e OZHQ-ve, Fondacioni North Milan Greater Area (NMGAF) është shndërruar në drejtues komuniteti dhe qendër njohurish. Me anë të kësaj qasjeje, fondacioni ka zbatuar 17 Objektiva, duke i lidhur me veprimtarinë e tij, angazhimin me të tjerët, dhe me punën e përditshme të organizatave vendore. Ky fondacion ka lidhur nivelin vendor me atë botëror, ka ndihmuar në identifikimin e treguesve, ka treguar vëmendje ndaj veprimeve, si dhe ka hedhur bazat për hartimin e një axhende të përbashkët për një sërë palësh interesi.

Fondacioni North Milan
Greater Area





» *“Ndonëse aktualiteti dhe puna e fondacionit nuk ngjallte shumë interes dhe ulerësim, unë nuk u shkurajova, pasi besoja fort në faktin se ndërmarrja e veprimeve në kontekstin botëror dhe të kuptuarit se të gjithë duhet të përpiqemi për t'i arritur dhe për t'i përvetësuar Objektivat, përbëjnë një sfidë madhore për personat e angazhuar ndaj kësaj çështjeje. Unë mendoj se prania e vazhdueshme e kësaj tematike duket e pashmangshme.”*

Susanne Hauswaldt,
Fondacioni Komunitar i Braunschvajgut

Fondacionet e suksesshme të Hamburgut dhe Braunschvajgut, të themeluara para 20 vjetësh, janë frymëzuar nga modeli i nismës „Vital Signs“ në Kanada, duke e përshtatur në nivel kombëtar në Gjermani. Nisma ImPULS Hamburg ishte e para që ofroi analiza të nevojave, të drejtuara nga komuniteti, në bashkërendim me OZHQ-të. Këto analiza u realizuan edhe nga Fondacioni i Braunschvajgut në fillim të vitit 2020. Pavarësisht vështirësive për ta bindur bordin dhe kolegët e saj, Susanne Hauswaldt, Drejtuesja Ekzekutive e Fondacionit Komunitar të Braunschvajgut, vijoi me realizimin e idesë së saj. Raporti i parë i ImPULS Braunschweig do të publikohet brenda vitit 2020 dhe fondacioni komunitar do ta përdorë për të vendosur çështjet e qytetit në kuadrin dhe në kontekstin e OZHQ-ve. Në këtë mënyrë qartësohet ideja

e OZHQ-ve dhe vërtetohet lidhja ndërmjet qytetarëve, veprimeve të tyre, dhe Objektivave të OKB-së. Përmes ImPULS, fondacioni komunitar lidh veprimet në nivel vendor me OZHQ-të, përmes punës së tij dhe diskutimeve të gjera me palë të tjera interesi mbi nevojat e qytetit.



IMPULS,
Fondacioni Komunitar i
Braunschvajgut



Ústecká komunitní nadace



» *“Ne vërejmë një potencial të madh të pashfrytëzuar në promovimin e OZHQ-ve dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë. Një nga zgjidhjet është angazhimi i universitetit të qytetit dhe krijimi i bashkëpunimit të ngushtë në fushën e OZHQ-ve.”*

Petr Veselý,
Fondacioni Komunitar i Ustit

Me mbështetjen e programit GCLS, Fondacioni Komunitar i Ustit synon që OJF-të vendore, nismat qytetare, dhe donatorët e fondacionit të ndërgjegjësohen dhe të kuptojnë OZHQ-të. Si rrjedhojë, ky fondacion mobilizoi nismat vendore jofitimprurëse, dhe falë gatishmërisë së donatorëve,

arriti të mbështeste 21 projekte të paraqitura nga ata, në lidhje me 4 Objektiva (përkatësisht Objektivat 1, 3, 4 dhe 11). Idetë dhe veprimtaritë e projektit përqendroheshin te përmirësimi i kushteve vendore dhe iu përgjigjeshin prioriteteve vendore, teksa kontribuonin në zgjidhjet e nevojshme për sfidat globale dhe çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm.



Shkolla për Jetën,
Usti, Republika
Çeke



Fondacioni Komunitar i Tuzlës në bashkëbisedim me qytetarët.



PËRDORIMI I TERMINOLOGJISË SË OZHQ-ve



» *“Fondacionet komunitare luajnë një rol kyç në këtë rast. Në verën e vitit 2019, ne organizuam bisedime dhe takime me anëtarë të komunitetit, ku promovuam OZHQ-të dhe lehtësuam diskutime mbi fushat kërkimore dhe çështjet e komunitetit, të ngritura nga qytetarët. Janë zhvilluar tetë bisedime me komunitetin, ku morën pjesë më shumë se 300 qytetarë, shumica prej të cilëve nuk kishin dëgjuar kurrë më parë mbi OZHQ-të e OKB-së.”*

Jasna Jašarević,
Fondacioni Komunitar i Tuzlës

Duhet të kuptojmë se OZHQ-të nuk lidhen vetëm me mobilizimin e burimeve financiare, por kërkojnë ndryshime që përfshijnë metoda të reja pune midis sektorëve publikë, privatë dhe jofitimprurës. Ndonëse nga pikëpamja financiare do të jenë gjithnjë një aktor i vogël, fondacionet komunitare luajnë rolin e një katalizatori me anë të veprimeve të tyre të pavarura dhe menaxhimit të lidhjeve, stimulimit të diskutimeve dhe promovimit të bashkëpunimit.

Komunikimi i vazhdueshëm mbi një set prioritetesh të unifikuara mund të ndihmojë në krijimin e partneriteteve jo vetëm ndërmjet kontributit privat dhe të mirës publike, por edhe ndërmjet palëve përkatëse të interesit, me qëllim përmirësimin e njohurive dhe burimeve që nevojiten për të sjellë ndryshime. Terminologjia e OZHQ-ve duhet përdorur në të gjitha fazat, duke nisur nga dialogu fillestar, te ndërmarrja e veprimeve, deri te raportimi.

Takim i Grupit të Ekspertëve të Fondacionit Komunitar të Tuzlës



Fondacioni Komunitar i Northemптэнshajërit synon të identifikojë Objektivat që janë adresuar nga donatorë të veçantë dhe fonde programesh në raportimin e ndikimit, të nxisë diskutime në mbarë rrjetin mbi praktikatat më të mira, të promovojë veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimit, të zhvillojë workshop-e për mbështetjen e grupeve komunitare dhe organizatave bamirëse, me qëllim që të reflektojnë mbi mënyrën se si puna e tyre pasqyron një ose disa nga OZHQ-të e OKB-së.

Fondacioni Komunitar i Mynihut dhe Fondacioni Komunitar i Frajburgut e përdorin "qëndrueshmërinë" në të gjitha projektet që financojnë. Kriteret e tyre parashikojnë shprehimisht se aplikantët duhet ta vërtetojnë se si e arrijnë qëndrueshmërinë.

» *"Si Fondacioni Komunitar i Mynihut, ne mbështetim vetëm projekte që i përmbushin Objektivat e Axhendës."*

Carmen Paul,
Fondacioni Komunitar i Mynihut



Fondacioni Komunitar i Tuzlës në bashkëbisedim me qytetarët, Živinice 2019.



FILLONI NGA VETJA: ORGANIZATË E QËNDRUESHME

Çdo fondacion komunitar duhet të kryejë një analizë vetjake përmes lentes së OZHQ-ve dhe të kuptojë nëse arrin t'i zbatojë me përpikëri. Fondacioni mund t'iu përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- A mund të ndërgjegjësoj bordin, stafin dhe vullnetarët e tjerë mbi OZHQ-të, dhe a mund t'i zbatoj në mënyrë aktive?
- A synoj të nxis dhe të promovoj partneritete dhe bashkëpunim të efektshëm ndërmjet sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile?
- A e nxis barazinë, gjithëpërfshirjen dhe llogaridhënien në qeverisjen dhe vendimmarrjen time, përmes punësimit dhe angazhimit të vullnetarëve?
- A ka organizata ime politika të përshtatshme dhe praktika pune në lidhje me konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm?

Krahas kësaj, fondacioni duhet të marrë parasysh se cila është mënyra më e efektshme për të përdorur burimet fizike, financiare dhe njerëzore në mbështetjen e ndryshimit ose drejtimit. Në rast se e ka fuqinë e vyer të bashkimit, fondacioni duhet ta përdorë me efektshmëri.

E fundit, por jo nga rëndësia, të gjithë mund të kontribuojnë çdo ditë në një organizatë të qëndrueshme, si ajo e Frajburgut, ku vullnetarët, bordi dhe oficerët ekzekutivë përdorin vetëm mënyra të qëndrueshme për të shkuar në punë. Ose, sikundër ndodh me Shoqatën e Fondacioneve në Gjermani, ku stafi kërkon mënyra për të reduktuar plastikën, letrën dhe mbetjet. Ka shumë mënyra përmes së cilave ne si individë që punojmë në dhe për fondacionet komunitare mund të fillojmë ciklin e ndryshimit dhe të pyesim veten se ku dhe si mund të kontribuojmë të gjithë.





NGRITJA E NJË RRJETI KOMBËTAR PËR TË MËSUAR NGA NJËRI-TJETRI

Organizatat mbështetëse për fondacionet komunitare mund të luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në edukimin, partneritetin, risiprurjen, mbështetjen dhe gjetjen e zgjidhjeve bashkërisht. Sipas një ankete nga ECFI-ja, vetëm gjysma e OMFK-ve evropiane aktualisht promovojnë konceptin e OZHQ-ve midis fondacioneve komunitare në vendin e tyre. Shkaqet e këtij pasiviteti nuk lidhen me mungesën e interesit, por kryesisht me mungesën e kohës dhe kapaciteteve. Të tjerë mendojnë se niveli i ndërëgjegjësimit dhe i njohurive në vendin e tyre është i pamjaftueshëm për të nisur diskutimin rreth kësaj teme të re, pavarësisht rëndësisë që ajo mbart.

» *"Tanimë, duke pasur një rritje të interesit për këtë temë, dëshirojmë të zhvillojmë njohuri brenda organizatës, në mënyrë që të kontribuojmë në këtë diskutim."*

Rucsandra Pop, ARC, Rumani

Konferenca bienale e UKCF-së u dha mundësinë drejtuesve të punës në terren për të marrë pjesë në një seancë të lehtësuar nga Martha Wilkinson, Drejtore Ekzekutive e Fondacionit Komunitar të Devonit, si dhe për të diskutuar mbi rëndësinë e OZHQ-ve në nivel vendor. Që nga ky moment e në vijim, të 46 fondacionet komunitare në Mbretërinë e Bashkuar do të vazhdojnë dialogun e tyre në nivel kombëtar, përmes grupit të punës së UKCF-së për OZHQ-të .

Përmes gjashtë mbledhjeve në nivel rajonal, Aleanca e Fondacioneve Komunitare në Gjermani synon t'i ftojë përfaqësuesit e këtyre fondacioneve që të reflektojnë mbi rëndësinë që kanë OZHQ-të për ta.

Si një organizatë që mbështet zhvillimin e më shumë se 400 fondacioneve komunitare në Gjermani, Aleanca i shfrytëzon këto takime vjetore rajonale për të promovuar idenë e peshës që këto fondacione mund të kenë në nivel vendor, vetëm nëse rakordojnë veprimtarinë e tyre me OZHQ-të.

» *"Takimet mbi OZHQ-të do të organizohen në përputhje me njohuritë dhe nevojat vendore dhe ato rajonale nga përgjegjës rajonalë, të cilët janë një grup vullnetarësh me përvojë në terren. Gjatë një workshop-i (seminar), pjesëmarrësit do të përcaktojnë mundësitë e tyre individuale, në drejtim të ndryshimit të strategjive dhe punës operacionale "*

Ulrike Reichart, Drejtues i Aleancës së Fondacioneve Komunitare në Gjermani

Në Ukrainë, vetë fondacionet komunitare po pilotojnë një sistem novator të bashkëpunimit ndërsektorial në 13 komunitete vendase. Përmes Ndërveprimeve Inteligjente (NI), nga anglishtja Smart Interactions (SI), ata përzgjedhën OZHQ specifike që synohen të arrihen me ndihmën e NI-ve. Për shembull, OZHQ 16.7 (Të sigurohet vendimmarrje e përgjegjshme, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet), OZHQ 8.9 (Deri në vitin 2030, të hartohen dhe të zbatohen politikat për një turizëm të qëndrueshëm, që krijon vende pune e promovon kulturën e produktet vendase), OZHQ 1.A (Të sigurohet përdorimi i plotë i burimeve të ndryshme), OZHQ 4.7 (Të sigurohet që nxënësit të marrin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, duke përfshirë, për shembull përmes arsimit për zhvillim



të qëndrueshëm dhe stile jetese të qëndrueshme, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, promovimin e kulturës së paqes dhe mospërdorimit të dhunës, qytetarisë globale, vlerësimit të diversitetit kulturor dhe kontributit të kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm).

Akademia e Zhvillimit të Filantropisë në Poloni dhe Fondacionet Komunitare në Kanada janë tashmë të konsoliduara për sa i përket rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit lidhur me OZHQ-të. Nga njëra anë, Akademia ofron ndihmë financiare në formë grantesh përmes Programit 'Sfida Globale, Zgjidhje Vendore', ndërsa kanadezët, nga ana tjetër, ofrojnë një larmi veprimtarish në drejtim të promovimit të OZHQ-ve.

» *“Ne organizojmë webinarë (seminare online) dhe seanca trajnuese ballë për ballë rreth OZHQ-ve. Ne koordinojmë projektet tona ekzistuese dhe ato të ardhshme si edhe komunikimet me OZHQ-të. Madje, së fundmi kemi zhvilluar një proces konsultimi me anëtarët tanë, për t'i parashtruar qeverisë federale mendimet tona mbi përparësitë e komunitetit, që ta ndihmojmë qeverinë të përcaktojë përparësitë e strategjisë së saj kombëtare në drejtim të zbatimit të OZHQ-ve. Gjithashtu, po ndërtojmë një rrjet komunitar në internet për fondacionet komunitare dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile, me qëllim përfshirjen në OZHQ-të e Kanadasë Aleanca 2030. Së fundi, përveç selisë sonë, po krijojmë një hapësirë fizike që do të shërbejë si qendër e OZHQ-ve në Kanada”.*

Alison Sidney,
Fondacionet Komunitare në Kanada

ECFI-ja ndërmori nismën „Thirrje zgjimi për OZHQ-të”, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit midis fondacioneve komunitare për rëndësinë e OZHQ-ve. Duke qenë pjesë e axhendës së veprimtarive të të nxënit nga kolegët, prezantimeve dhe konferencave, kërkimeve dhe komunikimeve, kjo ka qenë një temë që ka përshkuar të gjithë veprimtarinë e ECFI-së. ECFI-ja tashmë po ndjek një qasje më proaktive, duke siguruar mbështetje për të kuptuar aktualitetin e OZHQ-ve dhe harmonizimin me objektivat, si dhe duke përdorur kuadrin e OZHQ-ve për të treguar rëndësinë dhe ndikimin e strategjive dhe punës së tyre. ECFI-ja do të angazhohet me OMFK-të dhe, kur të jetë e mundur, do të hartojë dhe organizojë workshop-e për këtë temë. Përpos kësaj, ne do të vazhdojmë të mbledhim histori të rasteve nga terreni, për t'i publikuar në faqen tonë të internetit. 🌐



SI MUND TA REALIZOJMË 10 VEPRIME PËR TË PËRKRAHUR OZHQ-TË

Qëllimet ambicioze të OZHQ-ve mund të duken shumë larg punës së përditshme të fondacioneve komunitare. Megjithatë, nëse fondacionet komunitare njihen si katalizatorë për ndryshime në nivel vendor, atëherë OZHQ-të nuk janë vetëm të rëndësishme, por ofrojnë njëkohësisht edhe një kuadër që mund të ndihmojë fondacionet komunitare

të bëjnë një lidhje kyç midis masave në nivel vendor dhe objektivave globalë. Sikurse përshkruhet në kapitullin 'Fondacionet komunitare në veprim', kjo gjë mund të konsolidojë dhe të përmirësojë rolin, pozicionin dhe ndikimin e fondacioneve komunitare.



CILI ËSHTË HAPI I PARË?

Përkrahja e OZHQ-ve mund të duket një sfidë e guximshme. Më poshtë sugjerojmë disa veprime të arritshme:

1. Zhvilloni njohuritë tuaja rreth OZHQ-ve (17 objektivat dhe 169 qëllimet)
2. Krijoni burimin tuaj të materialeve referencë dhe të praktikës së mirë
3. Eksploroni dhe mësoni se çfarë kanë realizuar fondacionet e tjera komunitare
4. Reflektoni se si lidhet veprimtaria dhe nevojat specifike në lokalitetin tuaj me objektivat globale dhe krijoni një ide se çfarë ndikimi mund të kenë këto OZHQ
5. Identifikoni se me kë duhet të ndërveproni në lokalitetin tuaj dhe krijoni një koalicion interesi
6. Reflektoni se si mund të nisni një diskutim rreth OZHQ-ve brenda organizatës suaj, në veçanti me bordin
7. Qartësoni përfitimin që sjell përkrahja e OZHQ-ve brenda organizatës suaj, si dhe pasojat e zbatimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse (misionin, investimet, strategjitë dhe programet, komunikimet, operacionet)
8. Nëse ekziston një projekt i përshtatshëm, merrni parasysh që të aplikoni në Fondin 'Sfida Globale, Zgjidhje Vendore'
9. Koordinoni punën tuaj me OZHQ-të, duke marrë në konsideratë grupet e ndërvarura
10. Identifikoni burimet e të dhënave ose mënyrat e grumbullimit e tyre, gjë e cilado t'ju japë mundësinë të matni ecurinë dhe ndikimin tuaj



NDRYSHIMI VJEN NGA POSHTË – SI NDIKON AKADEMIA NË NXITJEN E PUNËS NË TERREN NGA KAJA PETRYKA



Kaja Petryka është Koordinatore e Projekteve Ndërkombëtare në Akademinë për Zhvillimin e Filantropisë në Poloni.

 <https://www.filantropia.org.pl/eng>

 <http://www.localsolutionsfund.org/>

THE ACADEMY FOR THE DEVELOPMENT OF PHILANTHROPY IN POLAND

Akademia për Zhvillimin e Filantropisë në Poloni u themelua në vitin 1998, me bindjen se përmes zhvillimit të filantropisë moderne, bota mund të shndërrohet në një vend ku njerëzit besojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin, ndajnë përvojat e tyre dhe i zgjidhin problemet së bashku. Ajo mbështet komunitetet vendase, shpërblen kompanitë e angazhuara shoqërisht, si dhe nxit njerëzit për të ndihmuar njëri-tjetrin.

GCLS

Krahas nismave të tjera, Akademia, përmes Programit „Sfida Globale, Zgjidhje Vendore“, mbështet organizatat dhe komunitetet në të gjithë Evropën, të cilat dëshirojnë të veprojnë në nivel vendor për OZHQ-të.



Fondi 'Sfida Globale, Zgjidhje Vendore' (GCLS), është fondi i parë evropian që angazhon komunitetet ndaj OZHQ-ve. Ky është një program për dhënie e granteve, i cili mbështet fondacionet komunitare dhe organizatat vendore filantropike në të gjithë Evropën, duke adresuar sfidat globale në nivel vendor. Kaja Petryka ndan me një pasqyrë të arritjeve të programit, që prej fillimit të tij në korrik të vitit 2016.

Sipas Programit 'Sfida Globale, Zgjidhje Vendore', komunitetet e vetorganizuara, të mbështetura nga burime vendore filantropike, luajnë rol kyç në adresimin e problematikave të shoqërisë sonë, si dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Madje, edhe problemet më të mëdha dhe më të rëndësishme shoqërore mund të zgjidhen në mënyrë më efikase në nivel vendor, pra duke filluar veprimet nga poshtë. Ose të paktën kjo do të ishte mënyra ideale për zgjidhjen e tyre. Nëse nuk ka mbështetje dhe mirëkuptim në nivel vendor ose nëse drejtuesit e këtij niveli tregohen pasivë dhe nuk i orientojnë burimet drejt zgjidhjeve, atëherë problemet do të mbeten të pazgjidhura.

Ne kemi bindjen e plotë se komunitetet vendase duhet të luajnë rolin kryesor në procesin e zgjidhjes së një problemi global. Nëse komunitetet vendase nuk ndërmarrin nismat bazë, zgjidhja e problemeve globale në kuadër të OZHQ-ve (p.sh. zhdukja e varfërisë së të gjitha formave kudo në botë, sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës, të barabartë dhe cilësor, si dhe promovimi i mundësive të të nxëniet gjatë gjithë jetës për të gjithë, bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore përfshirëse, të sigurta, të forta dhe të qëndrueshme) do të jetë e pamundur. Ndryshimi vjen nga niveli vendor, prandaj nëse duam të fuqizojmë dhe të nxisim komunitetet vendase për të marrë pjesë në këto procese, nevojitet nxitja e solidaritetit duke vlerësuar vlerat e filantropisë së komunitetit (tolerancën, empatinë, kujdesin dhe paqen), si dhe duke i frymëzuar përmes promovimit të praktikave të mira.

Megjithatë, mbështetja e jashtme është e domosdoshme për t'i bërë veprimtaritë e komunitetit vendas sa më të qëndrueshme dhe efikase. Një mbështetje e tillë mund të sigurohet nga fondacionet komunitare (FK-të) dhe organizatat komunitare filantropike, institucione që përdorin jo vetëm burime





Fondacioni Komunitar
'Donation Fund Sliven'

vendore, por gjithashtu kanalizojnë kapitalin shoqëror dhe e orientojnë komunitetin drejt ndryshimit. Ata veprojnë si katalizator i filantropisë komunitare dhe mund të shërbejnë si mbikëqyrës dhe udhërrëfyes, të cilët ndajnë praktikën më të mirë dhe një larmi mënyrash për zgjidhjen e problemeve sociale me komunitetet vendase.

Donatorët hezitojnë të mbështesin nismat novatore nga fondacionet komunitare, kjo pasi ato konsiderohen si investime të rrezikshme; po kaq e vështirë është edhe përfitimi i mbështetjes financiare për asistencë teknike. Kështu, bazuar në përvojën tonë në Programin për Zhvillimin e Fondacioneve Komunitare V4, i zbatuar në Republikën Çeke, Sllovaki, Poloni dhe Hungari, mësuam mbi rëndësinë e mbështetjes së jashtme për organizatat të tilla, e cila shërben si shtysë drejt zhvillimit dhe ndryshimit në komunitetet vendase. Ishte pikërisht kjo arsyeja përse vendosëm të ngremë Fondin 'Sfida Globale, Zgjidhje Vendore', një program financimi afatgjatë që siguron grante të vogla për fondacionet komunitare në të gjithë Evropën, me qëllim identifikimin dhe zbatimin e zgjidhjeve vendore për sfida globale. Projektet e zbatuara nga grantmarrësit tanë, duhet t'u përmbahen Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Në këtë program, ne:

1. organizojmë një **Konkurs evropian për grantet** për të mbështetur financiarisht veprimtaritë në nivel vendor që adresojnë OZHQ-të, si dhe për të grumbulluar praktika të mira,
2. organizojmë një **fushatë evropiane për arsimin** për të treguar se problematikat dhe projektet e lidhura me OZHQ-të janë të pranishme në çdo komunitet, si dhe për të dhënë udhëzime rreth mënyrës së trajtimit të tyre,
3. lehtësojmë **rrethin evropian të fondacioneve komunitare**, të angazhuar në zhvillimin e veprimtarive të ndryshme që adresojnë OZHQ-të në nivel vendor, duke organizuar grupe tematike dhe takime ndërkombëtare.

Gjatë zbatimit të programit, konstatuam se fondacionet komunitare ndahen në dy grupe. Grupi i parë është i gatshëm të zbatojë projekte të bazuara në OZHQ-të. Disa prej tyre kanë zbatuar edhe më parë projekte të ngjashme dhe shprehin dëshirën për t'u përfshirë në këto nisma. Sipas grupit të dytë, OZHQ-të nuk konsiderohen shumë të rëndësishme dhe punojnë më së shumti brenda organizatës, me projektet e tyre individuale, duke shmangur përfshirjen në nisma të reja. Veprimtaritë tona edukuese dhe promovimi i praktikave tona të mira realizohen kryesisht për grupin e fundit.



Fondacioni 'Obrenovac Youth'




Qëllimi ynë është të ndërgjegjësojmë fondacionet komunitare se pavarësisht faktit se shumë prej tyre i zbatojnë tashmë OZHQ-të në veprimtaritë e tyre, ata nuk kanë mjaftueshëm informacion rreth tyre. Gjithashtu, dëshirojmë t'u tregojmë se sa e rëndësishme është zgjidhja e sfidave globale duke nisur nga niveli vendor.

Gjatë tri viteve të programit 'Sfida Globale, Zgjidhje Vendore', kemi marrë 136 aplikime nga 17 vende (Rumani, Sllovaki, Itali, Bullgari, Ukrainë, Poloni, Republika Çeke, Mbretëri e Bashkuar, Hungari, Serbi, Irlandë, Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë, Letoni, Maltë, Spanjë, Maqedoni).

Më poshtë renditen projektet e zbatuara nga përfituesit tanë të grantit që lidhen me shumicën e objektivave, ku ndër më të shpeshtat janë:

- OZHQ 1 Zhdukja e varfërisë së të gjitha formave kudo në botë,
- OZHQ 3 Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat
- OZHQ 4 Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe të barabartë, si dhe promovimi i mundësive të të nxënimit gjatë gjithë jetës për të gjithë,
- OZHQ 5 Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave,
- OZHQ 11 Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore përfshirëse, të sigurt, të forta dhe të qëndrueshme.





Gjatë periudhës 2017-2019, kemi dhënë 29 grante me një vlerë të përgjithshme prej afro 500 000 USD. Grantet u janë dhënë organizatave në: Bosnje-Hercegovinë, Poloni, Rumani, Republika Çeke, Bullgari, Mbretëri e Bashkuar, Sllovaki, Letoni, Serbi, Ukrainë, Kroaci dhe Hungari.

Sa i përket nivelit dhe cilësisë së propozimeve, mund të themi me bindje të plotë se përmirësimi i tyre sa vjen e rritet. Organizatat po përpiqen të përshkruajnë sa më qartë përfshirjen e OZQH-ve në projektet e tyre. Madje, është konstatuar një rritje e përfshirjes së komunitetit në projekte. Informacione të tjera rreth ndikimit do të publikohen në fillim të vitit 2020.

Në vitin 2020, do të organizojmë një mbledhje për të gjithë përfituesit e granteve tona, do të organizojmë disa webinar-e dhe veprimtari të tjera edukuese, si dhe do të nisim një raund/thirrje tjetër për grante. Për të gjitha fondacionet komunitare që dëshirojnë të qëndrojnë të përditësuara me planet tona, i ftojme të ndjekin profilin tonë në Facebook. Nëse dëshirojnë të kontribuojnë financiarisht, duhet të përgatisin një projekt që lidhet me OZHQ-të, i cili edukon komunitetin vendas rreth këtyre të fundit, si dhe që dëshiron ta përfshijë këtë komunitet në zgjidhjen e sfidave globale në nivel vendor, për të aplikuar më pas përmes faqes sonë të internetit. Ju rekomandojmë të lexoni rreth praktikave të mira, informacion të cilin mund ta gjeni këtu:

 <http://www.localsolutionsfund.org/good-practices/>

**PËR MË SHUMË INFORMACION,
KONTAKTONI:**

Kaja Petryka
K.Petryka@filantropia.org.pl



Edukimi për Qarkullimin
me Biçikletë, Odorheiu,
Rumani





KANADA – PËRGATITJA E TERRENIT

NGA ANDREA DICKS



Andrea Dicks, President i Fondacioneve Komunitare në Kanada.

 <https://www.communityfoundations.ca/our-purpose/>

'Community Foundations of Canada' është rrjeti i kombëtar i 191 fondacioneve komunitare në Kanada, i cili mbulon 90% të komuniteteve në të gjithë territorin kanadez. Ne realizojmë bashkëpunime ndërsektoriale për të ndihmuar Kanadanë të krijojë komunitete të forta dhe të qëndrueshme, si dhe po punojmë për të adresuar, përmes një qasjeje holistike, problematikat e përshkuara në Axhendën 2030, nga ndryshimi i klimës te barazia gjinore.

FONDACIONET KOMUNITARE NË KANADA DHE OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Në shtator të vitit 2015, Kanadaja, krahas 192 shteteve të tjera, miratoi Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, një kuadër global 15-vjeçar, e përqendruar në shtatëmbëdhjetë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ndonëse ecuria e Kanadasë ishte më e ngadaltë krahasuar me vendet e tjera në drejtim të përmbushjes së këtij angazhimi, disa fondacione komunitare nuk hezituan të shqyrtonin se çfarë do të sillte përparimi i kësaj axhende globale në kontekstin e komuniteteve të tyre vendase: si grantdhënës, zhvillues, investitorë të ndikimit, si dhe katalizatorë të njohurive dhe të dhënave të komunitetit.

Si kuadër, OZHQ-të janë kuptimplota. Ndonëse ambiciozë, ato kanë adresuar shumë prej problematikave që fondacionet komunitare po përpiqen të zgjidhin në komunitetet e tyre përkatëse.

Duke qenë të njëjta për të gjithë, ato ofrojnë mjedise favorizuese për mbështetjen e zhvillimit të partneriteteve të reja ndërsektoriale, për të na ndihmuar të rrisim ndikimin tonë edhe më tej.

Në vitin 2018, duke njohur potencialin e këtij kuadri vendor-global, si dhe duke umbështetur në drejtimin e hershëm të komuniteteve si



Fondacioni Komunitar i Londrës,
2018 – workshop për OZHQ-të

Tofino, Grand Prairie, Montreal dhe Londër (ndër shumë të tjera), CFC-ja miratoi OZHQ-të si kuadrin e tij udhëzues. Që prej asaj kohe, ne kemi punuar nga afër me fondacionet komunitare dhe një rrjet në rritje të partnerëve në të gjithë Kanadanë dhe nëpër botë, me qëllim krijimin e mundësive kuptimplota në sferën e edukimit, bashkëpunimit dhe ndikimit. Më poshtë trajtohen disa shembuj të këtij bashkëpunimi:

Ngritja e një rrjeti kombëtar

Aleanca 2030 është një rrjet kombëtar, ndërsektorial me më shumë se 1,600 anëtarë, i përkushtuar në drejtim të përmbushjes së OZHQ-ve në Kanada dhe jashtë saj. E drejtuar nga CFC-ja dhe e nisur në bashkëpunim me qeverinë kanadeze dhe një rrjet partnerësh në vitin 2018, Aleanca 30 po shndërrohet me hapa të shpejtë në qendrën kryesore për përfshirjen e Kanadasë në OZHQ-të, duke ofruar akses në një bazë të dhënash në rritje të organizatave, projekteve, ngjarjeve dhe burimeve të lidhura me OZHQ-të. Përpos kësaj, CFC-ja, përmes kësaj aleance, nisi transmetimin e 'No Little Plans (Nuk ka plane të vogla)', një podcast që trajton histori të vërteta në Kanada përmes lentes së OZHQ-ve.

Mbështetja për të dhënat e komunitetit të koordinuara me OZHQ-të përmes 'Vital Signs'
'Vital Signs (Shenja jetike)' është programi më i madh në Kanada për mbledhjen e të dhënave të drejtuara nga komuniteti. Të udhëhequra nga CFC-të dhe të drejtuara nga fondacionet komunitare në Kanada dhe në mbarë botën, ky program është bërë një mjet i rëndësishëm për të vlerësuar nivelin e jetesës së një komuniteti, si dhe për të mbështetur veprimet në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës.

Në vitin 2018, CFC-ja bashkëpunoi me Institutin Ndërkombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm (IISD) për të koordinuar treguesit e 'Vital Signs' me OZHQ-të, si dhe synon ta thellojë këtë bashkëpunim me prezantimin e një platforme të të dhënave nga 'Vital Signs' në vitin 2020. Së bashku, këto burime punojnë për të forcuar raportimin dhe vendimmarrjen në përputhje me OZHQ-të, si dhe për të përmirësuar proceset e Rishikimit Kombëtar mbi Vullnetarizimin (VNR) dhe Rishikimit Vendor mbi Vullnetarizimin (VLR) të Kanadasë.

Forcimi i kapaciteteve për fondacionet komunitare

Në vitin 2019, CFC-ja, në bashkëpunim me fondacionin 'Charles Stewart Mott' themeloi një institut të ri të të nxënit për OZHQ-të, duke u përqendruar në forcimin e kapaciteteve të filantropisë në Kanada në nivel global, në drejtim të përparimit të OZHQ-ve. Kjo nismë disavjeçare e të nxënit do të rrisë ndërgjegjësimin, aftësitë dhe ekspertizën në nivel komuniteti, për të kuptuar se çfarë roli transformues mund të luajnë fondacionet komunitare në përparimin e OZHQ-ve.

Qendra Kombëtare për Kanadanë dhe OZHQ-të

CFC-ja, në zemër të kryeqytetit kanadez, drejtoi zhvillimin e një „qendre” të OZHQ-ve, një hapësirë prej afro 1486 m² kushtuar nxitjes së bashkëpunimit ndërsektorial lidhur me OZHQ-të. E prezantuar në vitin 2019, kjo qendër e re ofron bashkëpunim fizik, hapësirë për laboratorë dhe evente, të bashkëmenaxhuara në partneritet me 'Impact Hub Ottawa'.

Nxitja e harmonizimit të rezultateve të komunitetit me OZHQ-të

CFC-ja po bashkëpunon edhe me fondacione dhe partnerë komunitarë në një shkallë

Të gjithë së bashku për vitin 2019 (All in 2019), konferenca përmbyllëse e Fondacionit Komunitar dhe seanca plenare 1.



të gjerë për të çuar përpara OZHQ të caktuara në Kanada. Disa shembuj të këtij bashkëpunimi përfshijnë si më poshtë:

- **Objektivi 5** (Barazia gjinore): CFC-ja është partneri vendas i Fondit të Barazisë prej 300 milionë USD, i cili ka krijuar një burim të qëndrueshëm financimi për organizatat dhe lëvizjet e grave që promovojnë barazinë gjinore. Si pjesë të kësaj nisme, CFC-ja po bashkëpunon me qeverinë kanadeze për të përparuar në lidhje me barazinë gjinore përmes grantdhënies për fondacionet komunitare. Gjithashtu, do të publikojmë tri raporte të 'Vital Signs' për vitin 2020, të përqendruara në gjendjen aktuale të barazisë gjinore në Kanada.
- **Objektivi 9 dhe Objektivi 17** (Industria, risiprurja dhe infrastruktura): CFC-ja ka bashkëpunuar me qeverinë kanadeze për të përkrahur zbatimin e Programit të Gatishmërisë së Investimit prej 22 milionë USD, duke mbështetur forcimin e kapaciteteve në sektorin e financave sociale të Kanadasë.

- **Objektivi 4** (Arsim cilësor): Në bashkëpunim me Bankën Mbretërore të Kanadasë (RBC), CFC-ja, krahas me shumë se 80 fondacioneve komunitare, ndërmorën 'Sfidën Komunitare të RBC-së drejt së Ardhmes', një mundësi që të rinjtë të zhvillojnë ide që adresojnë një nevojë urgjente sociale, ekonomike ose mjedisore brenda komunitetit të tyre. Pavarësisht se ky program krijon mundësi specifike arsimore dhe trajnuese punësimi për të rinjtë, rezultatet e tij do të adresojnë OZHQ të shumta në nivel komuniteti.

PËR MË SHUMË INFORMACION, KONTAKTONI

JP Bervoets,
Zëvendës President,
416 319 8111

jbervoets@communityfoundations.ca

Dana Decent

Menaxhere Projekti, për bashkëpunime:
226 747 5035

ddecent@communityfoundations.ca



Të gjithë së bashku për vitin 2019 (All in 2019), konferenca përmbyllëse e Fondacionit Komunitar dhe seanca plenare 2.

URL-të

PËR INFORMACIONE TË MËTEJSHME RRETH FONDACIONEVE DHE ORGANIZATAVE MBËSHTETËSE TË PËRMENDURA NË RAPORT, NDIQNI KËTO LIDHJE:

AKADEMIA PËR ZHVILLIMIN E FILANTROPISË NË POLONI

<https://www.filantropia.org.pl/eng>

<http://www.localsolutionsfund.org/>

ALEANCA E FONACIONEVE KOMUNITARE NË GJERMANI

<https://www.buergerstiftungen.org/de/>

SHOQATA PËR MARRËDHËNIET NË KOMUNITET (RUMANI)

<http://arcromania.ro/arc/en/>

FONDACIONET KOMUNITARE NË KANADA

<https://www.communityfoundations.ca>

<http://communityfoundations.ca/vitalsigns/sustainable-development-goals/>

FONDACIONI KOMUNITAR I BRAUNSHVAJGUT (GJERMANI)

<https://www.buergerstiftungbraunschweig.de>

FONDACIONI KOMUNITAR I FRAJBURGUT (GJERMANI)

<http://www.freiburger-buergerstiftung.de>

FONDACIONI KOMUNITAR I MYNIHUT (GJERMANI)

<http://www.buergerstiftung-muenchen-land.de>

FONDACIONI 'NORTH MILAN GREATER AREA' (ITALI)

<http://www.fondazioniordmilano.org/comunita-vitali-english-version/>

FONDACIONI KOMUNITAR I NORTHEMPTËNSHAJËRIT (MBRETËRI E BASHKUAR))

<http://www.ncf.uk.com>

FONDACIONI KOMUNITAR I TUZLËS (BOSNJE-HERCEGOVINË)

<http://www.fondacijatz.org/>

FONDACIONI KOMUNITAR I USTIT (REPUBLIKA ÇEKE)

<https://www.komunitninadace.cz/en>

PËR BURIME TË TJERA, NDIQNI KËTO LIDHJE:

PLATFORMA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR NJOHJEN E OZHQ-VE

Faqja e përgjithshme e internetit

<https://sustainabledevelopment.un.org/>

Transformimi i botës: Axhenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030

<https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication>

Treguesit e OZHQ-ve

<https://unstats.un.org/sdgs/indicators/database>

ROCKEFELLER PHILANTHROPY ADVISORS

Filantropia dhe OZHQ-të: Hapat e parë (Volumi 1): Kuptoni arsyen dhe mënyrën se si mund të punoni me OZHQ-të.

<https://www.rockpa.org/wp-content/uploads/2019/04/04-12-RPA-SDG-Guide-A-Final-WEB.pdf>

Filantropia dhe OZHQ-të: Mjete praktike për koordinim (volumi II): Mësoni se si të planifikoni, vlerësonit, raportoni dhe të veproni lidhur me OZHQ-të.

https://www.sdghilanthropy.org/system/files/2019-05/Philanthropy%20and%20the%20SDGs_Practical%20Tools%20for%20Alignment.pdf

KËSHILLI I FONDACIONEVE

Nga objektivat globale te ndikimi vendor (2016)

<https://www.cof.org/content/global-goals-local-impact>

Drejtim në Nivel Vendor, Ndikim Global Fondacionet Komunitare dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (2018)

<https://www.cof.org/content/local-leadership-global-impact-community-foundations-and-sustainable-development-goals>

CANDID

[SDGfunders.org](http://sdgfunders.org)

<http://sdgfunders.org/>

URL-të

PLATFORMA E FILANTROPISË PËR OZHQ-TË

Eksperti i Treguesve të OZHQ-ve

<https://www.sdgphilanthropy.org/sdg-indicator-wizard>

(Eksperti i treguesve të OZHQ-ve është një mjet virtual, i cili u jep mundësinë organizatave të koordinojnë misionin dhe objektivat e tyre me OZHQ-të. U krijua nga Platforma e Filantropisë për OZHQ-të, ndërsa widget-i mund të importohet në faqe të tjera interneti.)

Kjo platformë bashkëpunon me fondacionet për të koordinuar punën e saj me OZHQ-të, si dhe me organizata të ngjashme për të përshkallëzuar ndikimin.

<https://www.sdgphilanthropy.org/>

GJURMUESI I OZHQ-VE

Gjurmuesi i OZHQ-ve paraqet të dhëna për të gjithë treguesit e disponueshëm nga baza jonë e të dhënave 'Our World in Data (Bota jonë përmes të dhënave)' (<https://ourworldindata.org/>), duke përdorur statistika zyrtare nga Kombet e Bashkuara dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

<https://sdg-tracker.org>

RRETH ECFI-SË: NISMA EVROPIANE PËR FONDACIONET KOMUNITARE

Nisma Evropiane për Fondacionet Komunitare (ECFI) është një nismë bashkëpunimi kushtuar forcimit dhe promovimit të lëvizjes së fondacioneve komunitare në Evropë.

ECFI-ja drejtohet nga Shoqata Gjermane e Fondacioneve (Bundesverband Deutscher Stiftungen) dhe operon në bashkëpunim me Qendrën filantropike (Centrum pre filantropiu) në Sllovaki. Kjo nismë bashkëpunon me Fondacionet Komunitare (CF) dhe Organizatat Mbështetëse për Fondacionet Komunitare (OMFK), kryesisht duke lehtësuar dhe stimuluar bashkëveprimet për të mundësuar të mësuarit, zhvillimin e njohurive dhe fuqizimin. Përpos kësaj, është e angazhuar në hartëzimin dhe analizimin e veprimtarive të FK-ve, si dhe në shpërndarjen e informacionit për të lehtësuar zhvillimin e fushëveprimit. Qëllimi kryesor i ECFI-së është të shërbejë si pikë qendrore kontakti, për një përfshirje më të gjerë brenda lëvizjes globale të fondacionit komunitar.

TEORIA E NDRYSHIMIT TË ECFI-SË

Sipas ECFI-së, krijimi i hapësirave dhe mundësive për dialog në nivel ndërkombëtar, krijimi i marrëdhënieve dhe ndarja e përvojave dhe praktikave të FK-ve dhe praktikuesve të tjerë të filantropisë (në një larmi temash me rëndësi globale dhe ndërkombëtare) në nivele të ndryshme, do të ndikojë në kapacitetin, aftësinë, lidhjet dhe besueshmërinë brenda lëvizjes së FK-ve. Konkretisht, ECFI-ja synon të:

- lehtësojë të nxënit individual dhe organizativ, si dhe ekspertizën;
- frymëzojë individët dhe organizatat drejt udhëheqjes dhe veprimeve të përbashkëta;
- zhvillojë njohuri të bazuara në praktikë;
- fuqizojë FK-të për të trajtuar problematika të vështira në komunitetet dhe në trajektoret e tyre të zhvillimit;

- rrisë solidaritetin e ndërsjellë dhe të forcojë fushëveprimin e FK-ve në tërësi;
- shfrytëzojë hapësirat virtuale, mjetet dhe burimet në internet për të plotësuar ndërveprimet ballë për ballë

PËRPARËSITË STRATEGJIKE TË ECFI-SË

- Lehtësimi i ndërveprimit dhe i procesit të të nxënit, ndarja e njohurive të reja dhe nxitja e bashkëpunimit ndërmjet OMFK-ve në Evropë, me qëllim forcimin e infrastrukturës mbështetëse
- Frymëzimi dhe lehtësimi i zgjerimit të fushëveprimit të FK-ve në Evropë
- Stimulimi i FK-ve në Evropë për të ushtruar rolin e tyre drejtues në komunitet, si dhe për të bashkëpunuar për çështje të ngutshme, përfshirë këtu pabarazinë, migrimin dhe ndryshimin klimatik
- Zhvillimi dhe ndarja e njohurive rreth fushëveprimit të FK-ve në Evropë
- Mobilizimi i burimeve financiare dhe formave të tjera të mbështetjes, në drejtim të zhvillimit të fushëveprimit të FK-ve në Evropë
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe e njohjes së OZHQ-ve dhe rëndësisë së tyre në punën e fondacioneve komunitare në Evropë

KONTAKT

Anja Böllhoff

anja@communityfoundations.eu

James Magowan

james@communityfoundations.eu

<https://www.communityfoundations.eu/home.html>



U jemi mirënjohës fondacioneve 'Charles Stewart Mott', 'Robert Bosch Stiftung'
dhe 'Körper Stiftung' për mbështetjen e tyre.



Robert Bosch **Stiftung**

